



KORPORATA ENERJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

NUMER I DOKUMENTIT: 129179
DATA: 23.10.2007

Nr. 129179 - 23.10.2007

154
23.10.07
ALITAB/IB/HA/ZA
23.10.07

Për: Z. Ali Hamitin
Kryetar i Bordit të ZRrE

NGA: REMZI SHAHINI
DREJTOR MENAXHUES-KEK

KOPJE: KEK Bordi i Drejtorëve
Michael Farbman - USAID
Z. Fadil Ismajli – KOSTT
Kevin McCann – AKM

DATË: 23 Tetor, 2007

LËNDA: Aplikimi i KEK-ut për Tarifa

Do të dëshironim që të falënderojmë ZRrE për shkresën e saj të datës 10 tetor 2007 lidhur me aplikimin e ardhshëm të KEK-ut për tarifa dhe do të dëshironim të i japim përgjigjet dhe rekomandimet në vijim:

1. KEK-u pajtohet me vlerësimin e ZRrE-s për gjendjen e tanishme në Kosovë, në veçanti me kohën në zbatim të tarifave të reja. Pajtohemi që tarifat e reja nuk do të duhej të zbatoheshin para 1 prillit 2008. Hyrja në fuqi me datë 1 prill do të i përgjigjet fillimit të sezonit tarifor veror.
2. Do të dëshironim që të sjellim pranë vëmendjes së ZRrE-s tri detyrat kryesore të cilat janë kryer në KEK, detyra këto që kanë ndikim në aplikimin tarifor.
 - a. Janë përgatitur buxhetet operative dhe kapitale për 2008. Procesi buxhetor është forcuar duke mundësuar trajnime të menaxherëve të nivelit më të lart për format dhe proceset e reja. Megjithatë, buxhetet përfundimtare nga ana e të gjitha departamenteve ende nuk janë kryer por, pritet që ato të përfundojnë deri me 30 nëntor 2007. Parashohim se procesi i ri buxhetor, i cili është më rigoroz se ai i mëhershëm, do të mundësojë informacione më të mira (për të dy llojet, shpenzimet operative dhe kapitale) dhe besojmë se ai duhet të përdoret në procesin e aplikimit për tarifa.
 - b. Departamenti i KEK-ut për Çështje Rregullative është në proces të riorganizimit për reflektimin më të mirë të nevojave të rritura. Deri më tani janë pranuar CV-t për pozitën e Drejtorit dhe Menaxherëve ndërsa për këtë javë janë caktuar intervistat përkatëse. Konsulentët tonë ndërkombëtar, gjatë muajve të ardhshëm, do të mundësojnë trajnime të konsiderueshme për stafin e tahishëm dhe atij të ri, për të gjitha aspektet e rregullimit të ekonomisë së energjisë elektrike. Presim që kjo do të rezultojë në një përputhshmëri më të lart me kërkesat e ZRrE në të gjitha lëmit e rregullimit.
 - c. KEK-u është në proces të përgatitjes së një parashikimi të ri të ngarkesës, energjisë elektrike dhe burimeve. Parashikimi i ri do të mundësojë informacione dhe të dhëna

shumë të rëndësishme për pjesën e bilancit energjetik të aplikacionit për Tarifa. Përmirësimet buxhetore përfshijnë parashikimin më në thellësi të shfrytëzimit të energjisë nga ana e konsumatorëve sipas klasave tarifore si dhe përcaktim më rigoroz të prodhimit sipas njësive dhe kërkesave për import për 2008 dhe më tej.

3. Të premtën me datë 19 tetor 2007, KEK-u ka pranuar kopjet e modelit tarifor të ZRrE-së i cili ishte shqyrtuar nga ana e konsultantëve të ZRrE. Tanimë kemi filluar me procesin e vlerësimit të modelit dhe ndikimet që shqyrtimet në modelin paraprak mund të kenë në rezultatet përkatëse. Supozojmë se modeli i reviduar, në aspektin konceptual, nuk ndryshon nga modeli i përdorur për llogaritjen e tarifave të fundit, megjithatë, KEK-u ka ndërmend që të i jep supozimet e veta që janë përdorur në kuadër të modelit në vend të supozimeve të përdorura nga ana e konsultantëve të ZRrE-s.
4. KEK-u është i befasuar me orarin e caktuar të ZRrE të theksuar në shkresën e datës 10 tetor 2007. Si duket ZRrE-ja nuk është në harmoni me Rregullat e Caktimit të Çmimeve. Do të dëshironim të theksojmë Nenin 7.5 i cili thotë se KEK-u duhet të ketë së paku 30 ditë për përgatitjen e aplikacionit të vet për tarifa si dhe Nenin 8.5 i cili thotë se tarifat paraprakisht të aprovuara duhet të mbesin në fuqi për së paku 12 muaj.
5. Bazuar në datën e hyrjes në fuqi të tarifave të reja, 1 prill 2008, propozohet orari në vijim:
 - i. 15 dhjetor – Dorëzimi i Aplikacionit për Të Hyrat e Lejueshme për vitin 2008
 - ii. Nga 15 dhjetori deri me 31 janar – Shqyrtimi i aplikacionit për të hyrat e lejueshme nga ana e ZRrE-s duke përfshirë edhe diskutimet me Palët e Interesuara
 - iii. 1 shkurt, 2008 – Dorëzimi, nga ana e KEK-ut, i Propozimit për Dizajnin e Tarifave
 - iv. 15 shkurt, 2008 – Dorëzimi, nga ana e KEK-ut, i Bashkërenditjes së Të Hyrave të lejueshme me Kostot Aktuale të vitit 2007 (që do të përfshihen në Të hyrat e Lejueshme për 2008)
 - v. Nga 15 shkurti deri me 10 mars – Shqyrtimi i Tarifave nga ana e ZRrE-s dhe Palëve të Interesuara
 - vi. 15 mars, 2008 – Vendimi i ZRrE-s për Të hyrat e Lejueshme dhe Tarifat
 - vii. 1 prill, 2008 – Data e hyrjes në fuqi e tarifave të reja
6. KEK-u i ka komentet në vijim lidhur me Aplikacionin për Tarifa:
 - a. Të hyrat e Lejueshme –
 - i. KEK-u pajtohet me ZRrE-n për rifreskimin (përditësimin) e parashikimeve të të gjitha të hyrave të lejueshme
 - ii. KEK-u pajtohet se ndryshimi(et) "sipërfaqësore" të bëra në shqyrtimin e fundit tarifor nevojitet të faktorizohen në këtë shqyrtim tarifor
 - iii. KEK-u planifikon që të përcjell Metodologjinë Bazë Tarifore sa i përket llogaritjes së të Hyrave të Lejueshme.
 - b. Alokimi i Të Hyrave të Lejueshme –
 - i. Siç u tha më lart, KEK-u është në proces të plotësimit me staf të duhur të Departamentit të tij për Tarifa dhe krijimin e ekspertëve të duhur përbrenda shtëpisë së vetë. Nuk presim që të kemi burimet apo kohën e duhur për kryerjen e studimit gjithëpërfshirës për Kostot Margjinale Afatgjate (LRMC) dhe kostot e shërbimeve sipas klasës tarifore.
 - ii. Propozojmë që të përdorim faktorët e alokimit të cilët do të përgatiten pas përfundimit të studimeve të reja buxhetore dhe teknike për alokimin e nivelit të ri të të Hyrave të Lejueshme në klasat tarifore

c. Dizajni Tarifor – Edhe pse shkresa juaj thekson se ZRrE-ja mendon që të mbajë struktura të njëjta tarife, KEK-u beson se nevojiten disa ndryshime. KEK-u ka qenë i detyruar që të pranojë një dizajn tarifor për të cilin kemi ndjerë se nuk ishte në interesin më të mirë për kompaninë dhe shumë konsumatorë të tij. Çështjet që planifikojmë të i ngrisim në shqyrtimin e ardhshëm tarifor janë si vijon:

- i. Eliminimi i tarifës kohore për amvisëritë. Arsyet e këtij eliminimi i janë komunikuar ZRrE-s në aplikacionin origjinal të KEK-ut për tarifa në shkurt 2007. ZRrE-ja fillimisht është pajtuar me qëndrimin e KEK-ut por, ndërhyrja që pasoi nga Qeveria në procesin tarifor bëri që tarifa kohore të mbetet edhe më tej. Edhe pse nuk është bërë një studim detal, është mase e qartë për KEK-un se tarifat kohore nuk po shkojnë si duhet, kryesisht për shkak të faktit se orët tarifore që ngasin njehsorët nuk kanë bateri.
- ii. Zvogëlimi i 3 bllok strukturës tarifore në një apo dy blloqe.
- iii. Theksim më i vogël në mbulimin e kostove fikse gjatë ngarkesës dimërore. KEK-u do të mundësojë alokimin e kostove të veta i cili do të demonstrojë arsyetimin ekonomik të këtij propozimi.

d. Tarifa për Shfrytëzimin e Sistemit Shpërndarës (DUOS) –

- i. Siç është theksuar nga ana e ZRrE-s, nëse ndryshohet kufiri për privilegj, mbi të cilin konsumatorët mund të zgjedhin furnitorin e tyre (pra bëhen Konsumator të Privilegjuar), atëherë do të jetë e domosdoshme që të përgatitet një ngarkesë për Shfrytëzimin e Sistemit Shpërndarës (DUOS) sipas nivelit të tensionit (35 KV, 10 KV, 0.4 KV).
- ii. KEK-u nuk beson se kushtet e tregut gjatë disa viteve të ardhshme do të jenë të tilla që do të mundësojnë caktimin e ndonjë konsumatori tjetër si "Të Privilegjuar". Është e pabesueshme se çfarëdo prodhuesi apo tregtari i energjisë jashtë Kosovës, në një të ardhme të afërt, do të jetë i gatshëm të i mundësojë energji elektrike ndonjë konsumatori në Kosovë me një çmim më të ulët se çmimi i KEK-ut. Poashtu është e pabesueshme që ZRrE-ja do ta lejojë tarifën interne të Kosovës të ngritet në çmimim e nivelit mesatarë të rajon-it.
- iii. Prandaj, KEK-u beson se një Tarifë SHSSH (DUOS) nuk është e domosdoshme në këtë kohë. Me zhvillimin e ekspertëve të tij nga ana e Departamentit për Tarifa, në të ardhmen mund të përgatitet një Tarifë për SHSSH (DUOS) e cila do të i kënaqë kërkesat, kryesisht të sugjeruara nga ana e UE në Direktivat e veta dhe do të i lejojë konsumatorët e privilegjuar që të marrin pjesë në tregun energjetik.

7. Nëse ZRrE-ja do të duhej të vazhdojë me orarin e propozuar për aplikimi tarifor, KEK-u do të përgjigjet me informatat të cilat i kemi tani; sidoqoftë, në tërësi presim që ZRrE-ja do të lejojë ndryshimet para vendimit final të saj dhe kur në dispozicion do të jenë buxheti i ri dhe informacionet më të mira. Kjo është në harmoni me Rregullat për Caktimin e Çmimeve (Neni 9.3 thotë se: "Zyra e Rregullatorit të Energjisë mund të përfshijë dispozitat si pjesë e metodologjisë për llogaritjen e ndryshimeve brenda periudhës për një shqyrtim të gjithë apo një pjese të kontrollit të çmimit në rast se vlerat aktuale për parametrat e identifikuar lëvizin përtej një shkalle të definuar".


8. Si u përmend më herët, KEK-u është në proces të ndryshimeve që do të përmirësojnë kualitetin e informatave dhe të dhënave si dhe trajnimin dhe ndryshimet e riorganizimit të cilat do të përmirësojnë njohuritë dhe rrisin performancën e punëtorëve tonë. Ne besojmë se duke aplikuar për tarifa në tetor, duke përfshirë inkasimin, analizat dhe mundësimin e të gjitha të dhënave dhe informatave, mandej freskimin me të dhëna të reja më vonë, nuk paraqet një proces efikas për të dy, KEK-un dhe ZRrE-n. Po ashtu mund të shkaktojë konfuzion të panevojshëm dhe shqetësim për konsumatorët tanë dhe zyrtarët e qeverisë, ne veçanti kur të dhënat të përditësohen dhe tarifat e propozuara që rezultojnë të ndryshojnë nga aplikimi origjinal tarifor.

9. Që të dy, ZRrE-ja dhe KEK-u e kuptojnë rëndësinë e shërbimeve elektrike për ekonominë Kosovare dhe qytetarët e saj. Duke ditur përvojën e KEK-ut nga aplikimi paraprak në 2007, kemi shqetësimet në vijim:

- (a) Kohën për aplikacion për tarifa të reja dhe data e hyrjes në fuqi
- (b) Ndjeshmërinë për zgjedhjet e nëntorit;
- (c) Çështjet e mundshme të statusit në dhjetor dhe
- (d) Vonesa e mundshme në formimin e qeverisë së re
- (e) Tarifat të cilat kanë qenë të planifikuara paraprakisht dhe që janë pritur për muajin Maj 2007, grumbullimi i një porcioni domethënës i të hyrave të lejuara gjatë sezonës së dimrit; mund të ndryshojë nëse tarifa e re hynë në fuqi nga Janari 1, 2008.
- (f) Për më tej, nuk do të ishte mirë që tarifat të ndryshojnë me 1 janar meqë kjo është koha e tarifës dimërore të lart.
- (g) Në fund, nuk ka gjasa që KEK-u të ketë mundësi për zbatimin e tarifave të reja me 1 janar.

Propozojmë që ZRrE-ja dhe KEK-u të takohen dhe diskutojnë detajet për aplikimin tarifor dhe të merren vesh për orarin përkatës.

Me sinqeritet,


Remzi Shahini
Drejtor Menaxhues i KEK Sh.a.

